

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri me sekretaren juridike Donjeta Elezi në çështjen juridike të paditëses [REDACTED] Prishtinë, të cilën e përfaqëson [REDACTED], kundër të paditurit [REDACTED] nga Shtimja Rr." [REDACTED], në çështjen juridike rimbursim dëmi, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur, më datë 13.07.2015, në përfaqësuesit të paditëses dhe në prezencën e të paditurit, mori:

### AKT GJYKIM

**I. APROVOHET** në tërësi kërkesë padia e paditëses [REDACTED] Prishtinë, si e bazuar,

**II. DETYROHET** i padituri [REDACTED] nga Shtimja Rr." [REDACTED], që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit t'i paguajë shumën prej 1,170,00 € të gjitha me kamatën ligjore prej 3.5%, si për mjetet e afatizuara në bankë për një vit pa destinim të posaçëm nga dita e paraqitjes së padisë datë 24.12.2012, deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 40 €, të gjitha në afat prej 15 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

### Arsyetimi

Përfaqësuesi i paditëses në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pran padisë dhe kërkesë padisë duke theksuar se i padituri në aksidentin e komunikacionit me datën 31.08.2011, sa ka qenë duke e drejtuar automjetin e veturës Audi 80 me targa të regjistrimit [REDACTED] në Magjistralën Shtime-Prizren respektivisht në fshatin Carralevë Komuna e Shtimës, ku në momentin e aksidentit i padituri nuk ka qenë i siguruar respektivisht i ka skaduar periudha sigurimi, me të cilin i shkakton dëme material veturës Golf IV me targa të regjistrimit [REDACTED] pronë e [REDACTED].

I ka propozuar gjykatës që të aprovet kërkesë padia e paditëses si e bazuar si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I padituri në fjalën e tij ka deklaruar nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesë padisë së paditëses se është e vërtetë se me datën 31.08.2011, kam qenë duke e drejtuar automjetin Audi 80, deri sa ka qenë duke e tejkalluar një veturë ku me atë rast e ka goditur veturën Golf IV pronë e [REDACTED].

Në këtë aksident dëmet materiale të cilat i janë shkaktuar nuk përkojnë me shumën e cila iu është kompensuar nga ana e paditëses e cila tani me anë të kësaj padisë kërkon nga unë që ta rimbursoj dëmin e shkaktuar.

Konsideroj se dëmi material që i është shkaktuar në atë kohë nuk e ka kaluar shumën prej 200€.

I ka propozuar gjykatës që ta refuzon kërkesë padinë e paditëses mbi vlerën e sipërcekur si të pabazuar

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë nxjerrjen e provave: U lexua padia e paditëses e dt.24.12.2012, vendimi i paditëses i dt.21.09.2011 me nr. lëndës 1437/2011 me të cilën është aprovuar kërkesa e [REDAKTUAR] për dëmin në shumë prej 1.170€, ujdia jashtëgjyqësore e dt.23.09.2011 me nr.1437/2011, raporti i policisë CFT 3004-429-11 dt.31.08.2011, raporti i policit hetues CFT 3004-429-11 dt.31.08.2011, përgjigja në padi e të paditurit dt.17.03.2015, fletëparaqitja për kundërvajtje me nr.0424442 dt.31.08.2011

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimin të tyre, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia është e bazuar.

Gjykata me rastin e vlerësimin të bazueshmërisë së kërkesëpadisë, konsideron se e njëjta bazohet në provat e administruara dhe atë automjeti me të cilin është shkaktuar dëmi Audi 80 me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] nuk ka qenë i siguruar, ashtu që ndërmjet palëve ndërgjyqësore nuk është kontestuese baza juridike e kërkesë padinë por vetëm lartësia e regresit të dëmit material.

Me leximin e raportit të policitë hetues CFT 3004-429-11 dt.31.08.2011, gjykata ka vërtetuar se është shkaktuar aksidenti i komunikacionit në magjistralen Shtime - Prizren respektivisht në fshatin Carralevë në të cilin aksident kanë marr pjesë dy automjete Audi 80 me targa të regjistrimit [REDAKTUAR], të cilin e drejtonte i padituri [REDAKTUAR], dhe automjeti tjetër Golf IV me targa të regjistrimit të Italisë [REDAKTUAR] të cilën e drejtonte i dëmtuari [REDAKTUAR]

Deri te aksidenti ka ardhur ku i padituri deri sa ishte duke e drejtuar automjetin hynë në tejkalim në kthesë të padukshme në shiritin e kundërt në vijë të plotë, e godet veturën Golf IV e cila ishte duke shkuar në drejtim të Prizrenit me të cilin aksident i shkaktonte dëme materiale.

Me vendimin GFK.nr.1437/11 dt.21.09.2011 të Fondit të Garancisë së Kosovës, në bazë të provave , ujdia jashtëgjyqësore, leximi i faturave të pagesës transferi i mjeteve për të dëmtuarin [REDAKTUAR] të autorizuarit të tij [REDAKTUAR] i

dt.06.10.2011,gjykata ka vërtetuar se nga aksidenti i komunikacionit është shkaktuar dëm material në automjetin e udhëtarëve Golf IV pronë e të dëmtuarit [REDACTED]

Sipas komisionit Komisionit ka vlerësuar se dëmi i shkaktuar është në shumë prej 1.170€, të cilën shumë i dëmtuari e ka pranuar.

Gjykata bazuar në vlerësimin e provave lidhur me faktet, ka vërtetuar se i padituri [REDACTED] nga Shtimja Rr.” [REDACTED] duke e drejtuar automjetin Audi 80 në rrugën Shtime – Prizren respektivisht në fshatin Carralevë duke tejkaluar në vijë të plot dhe në kthesë pa dukshmëri e ka goditur veturën Golf IV pronë e të dëmtuarit [REDACTED] i cili ka qenë duke ecur në anën e kundërt me të cilin të dëmtuarit i ka shkaktuar lartësinë e dëmit të aprovuar në kërkesë padinë.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së dhe në dispozitat e nenit 178 par.1 të LMD-së dhe nenit 18 të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshme, sepse rasti i siguruar nuk ka qenë i siguruar meqenëse rasti nuk është i mbuluar me polis të sigurimit dhe ka detyruar të paditurin të bëjë regresimin e dëmit në shumë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të shpërblimit të dëmit material, paditësit ja ka njohur të drejtën në kamatë ligjore prej ditës së ushtrimit të padisë dt. 24.12.2012, deri në pagesën definitive si për mjetet e deponuara në banka mbi një vit, pa destinim të caktuar, në kuptim të nenit 277 al.1 të LMD-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, andaj i padituri obligohet të paguaj 50 € dhe atë për taksë gjyqësore për padi shumë prej 25€ dhe aktgjykim prej 25€, e cila është llogaritur në bazë të shumës së aprovuar të kërkesëpadisë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**C.nr.719/12, dt. 13.07.2015.**

Gjyqtari  
Alban Beqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

VENDIMI ËSHTË I PLOTËDORSHËM  
ODLUKA JE PRAVNOBNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROSEVAC

13.08.2015